



Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, të nenit 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 21 qershor 2016, të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe neneve 9,17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ZK- LIPJAN 15Nr.463/02-17208 TË MIRATUAR ME DATËN 29.03.2024

Neni 1

1.Me këtë Vendim, korrigjohet neni 1 i Vendimit paraparak 15Nr.463/02-17208 datë 29.03.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan dhe riformulohet si në vijim:

MIRATOHET Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për personat fizik dhe juridik paluajtshmeritë- pronat komunale që gjenden në ZK Lipjan të përshkruara si më poshtë:

Njësia Kadastrale P-71409044-01736 -1, në sipërfaqe prej 1110 m², Zona Kadastrale në Lipjan;
Njësia Kadastrale P-71409044-01742 -4, në sipërfaqe prej 624m², Zona Kadastrale në Lipjan;
Njësia Kadastrale P-71409044-01743-5, në sipërfaqe prej 803m², Zona Kadastrale në Lipjan;
dhe Njësia Kadastrale P-71409044-01748-2, në sipërfaqe prej 765m², Zona Kadastrale në Lipjan

Sipërfaqja e përgjithshme e pronave 3302 m².

Neni 2

Njësia kadastrale P-71409044-01736-2 në sipërfaqe prej 1457m² në ZK Lipjan, me Aktvendimin Nr.ref.72-2024 datë 08.04.20224 të Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër është modifikuar sipas detyrës zyrtare, parcela nr.1736-1 me 1736-2 gjegjesisht është bërë permutacion në grafikë i numrave të parcelave 1736-1 dhe 1736-2 në ZK Lipjan dhe e njëjta ishte e publikuar në Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që janë planifikuar për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues 2024 me nr.01-462/01-68402 të datës 15.12.2023 në numrin rendor 21, ku parcela P-71409044-01736-2 në sipërfaqe prej 1457m² në ZK Lipjan zëvendësohet me parcelën P-71409044-01736-1 në sipërfaqe prej 1110 m² në ZK Lipjan.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësores-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-462/01-22762

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

